



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 21 mars 2014

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121; në mbështetje të rregullit 16 dhe të rregullit 17 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; si dhe në mbështetje të Rregullores, Nr. 02/2013, për Procedurat e rekrutimit, të emërimit dhe të punës provuese të stafit të Gjykatës Kushtetuese, Sekretariati shpall:

KONKURS
Për plotësimin e vendit të punës

1.

Pozita: Redaktor/Lektor për gjuhë serbe (1)
Kodi: SP-DPP B 02
Kohëzgjatja e emërimit: I karrierës (pa afat)
Puna provuese: Një (1) vit

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Përkujdesja për redaktimin dhe për lekturën e shkresave sipas standardeve të gjuhës serbe dhe në përputhshmëri të plotë me gjuhën e ligjit dhe me standardet e Gjykatës, si dhe për ofrimin e shërbimeve të redaktimit, të lekturës dhe të dukjes së teksteve të Gjykatës Kushtetuese, nën mbikëqyrjen e drejtorit të Departamentit për Përkrahje Profesionale.

- Redakton/lekturon me shkrim materiale dhe dokumente të Gjykatës Kushtetuese;
- Redakton aty për aty, në gjuhën serbe, dokumente dhe shkresa të Gjykatës;
- Përkujdeset për strukturën e fjalëve dhe të fjalive në dokumentet e përkthyer në gjuhën serbe;
- Ndhmon në përcaktimin dhe në harmonizimin e terminologjisë së gjuhës serbe për tekstet e përkthyer;
- Mirëmban sistemin e arkivimit të materialeve të redaktuara dhe të lekturuara në mënyrë korrekte dhe të besueshme;
- Ndhmon në përpilimin e terminologjisë së standardizuar ligjore dhe administrative serbe;
- Ndhmon dhe shoqëron përkthyesit dhe të tjerët, profesionalisht, për drejtshkrimin e gjuhës serbe; dhe
- Kryen edhe punë të tjera, sipas kërkesës së drejtorit të Departamentit të Përkrahjes Profesionale.

Kualifikimet minimale, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Përgatitje superiore shkollore, dhe
- Së paku tri (3) vite përvojë pune.

Kandidati për pozitën e Redaktorit/Lektorit për gjuhë serbe duhet të jetë energjik, të ketë shkathtësi të mira ndërnjerëzore dhe të jetë i gatshëm të punojë me orar fleksibil të punës. Është e domosdoshme shkathtësia dhe aftësia në përdorimin e kompjuterit dhe të softuerëve aplikativë, si: MS Word, përfshirë përpunimin e avancuar të tekstit, MS Excel dhe MS Outlook.

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Përcaktimi i pagës për pozitën e shpallur bëhet në përputhje me Rregulloren e punës dhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë dhe komunitetet joshumicë e pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional.

Procedura e konkurrimit:

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar nga një biografi personale, një letër motivuese dhe dokumentacionin përkatës për përgatitjet shkollore dhe për përvojën e kërkuar të punës.

Forma e aplikacionit mund të merret në kopje fizike në recepcionin e Gjykatës Kushtetuese dhe mund të shkarkohet nga ueb-faqja e Gjykatës Kushtetuese: www.gjk-ks.org

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, mund të dërgohet nëpërmjet e-mailit në adresën: lulzim.syla@rks-gov.net, nëpërmjet shërbimit postar apo në Zyrën e Departamentit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore (DABNJ) të Gjykatës Kushtetuese në kopje fizike.

Data e fundit për pranimin e aplikacioneve është **04/04 /2014, deri në ora 16.00.**

Shënim:

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit, nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen. Për shkak të numrit eventual të madh të kërkesave të pranuar, do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë.